



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Ligji Nr. 05/L -078**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-019  
PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E  
PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-019  
PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E  
PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

**Neni 1**

Qëllimi i këtij ligji, është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

**Neni 2**

1. Neni 3 i ligjit bazik, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

### Neni 3

#### 1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj, kanë këtë kuptim:

1.1. **Aftësia e kufizuar** - kufizim në qasje dhe aktivitete të zakonshme në jetën e përditshme të një personi, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, intelektuale ose mendore, që e pengojnë atë për pjesëmarrje në aktivitete të zakonshme ditore;

1.2. **Personat me aftësi të kufizuara** - personat që kanë dëmtime fizike, shqisore, intelektuale ose mendore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët;

1.3. **Kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, si pasojë e dëmtimit** - Invalidin e luftës, invalidin civil të luftës, invalidin e punës, personi i lindur me dëmtime fizike, shqisore, intelektuale ose mendore, dhe personi i cili si shkak i fatkeqësisë apo sëmundjes ka aftësi të kufizuar fizike, shqisore, intelektuale ose mendore;

1.4. **Komisioni Mediko-Social** - ekip i përbërë prej ekspertësh mjekësor dhe ekspert të lëmive të tjera, i themeluar nga institucioni përkatës, me qëllim të konstatimit dhe vlerësimit të shkallës së aftësisë së kufizuar të një personi;

1.5. **Aftësimi dhe riaftësimi profesional** - të gjitha aktivitetet që synojnë të sigurojnë njohuri, shkathtësi të reja për punë efikase brenda profesionit që e ka kryer edhe më parë, apo për një profesion tjetër që personi me aftësi të kufizuar mund t'a kryejë me sukses;

1.6. **Përshtatshmëria e mjedisit** - masat e ndërmarra me qëllim të sigurimit të një mjedisi pa barriera të natyrave të ndryshme për sigurim të qasjes së përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar;

1.7. **Mjetet ndihmëse** - mjete të cilat i përdorin personat me aftësi të kufizuara, me qëllim të tejkalimit të pengesave të cilat e kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të zakonshme;

1.8. **Punë e përshtatshme** - punën të cilën e kryen personi me aftësi të kufizuara në përputhje me mundësitë e tij fizike, shqisore, intelektuale ose mendore si dhe me kualifikimin përkatës të fituar gjatë shkollimit të rregullt apo specifik, apo aftësimit dhe riaftësimit profesional;

1.9. **Trajneri** – profesionist i certifikuar, i cili ka mandat nga Qendra për Aftësim Profesional – QAP, që të organizoj procesin teorik dhe praktik të aftësimit dhe riaftësimit profesional të kandidatëve të përfshirë në trajnim, t'i vlerësoj kandidatët për njohurit dhe shkathtësitë e arritura gjatë trajnimit;

1.10. **Edukimi specifik** - proces arsimor i aprovuar nga organet kompetente arsimore për plotësimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara;

1.11. **Asistenti** - person i domosdoshëm pa të cilin personi me aftësi të kufizuar nuk mund të aftësohet apo të riaftësohet për punë, ose të krijojë marrëdhënie pune;

1.12. **Punëtorja mbrojtëse** - ndërmarrje që themelohet me qëllim të ofrimit të punës dhe të punësimit të përshtatshëm, në vendin dhe hapësirën me pajisje përkatëse për personat me aftësi të kufizuara;

1.13. **Qendra punuese** - vend punishte e specializuar që punëson persona me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të punësohen apo ta mbajnë punën, sipas kushteve të përgjithshme, dhe të veçanta në punëtorinë mbrojtëse;

1.14. **MPMS** - Ministrinë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale;

1.15. **APRK** - Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës;

1.16. **QAP** - Qendrat e Aftësimit Profesional të themeluara nga MPMS-ja që ofrojnë shërbime për aftësim, riaftësim dhe kualifikim të punëkërkuesve, me qëllim të rritjes së mundësive për punësim produktiv dhe vetëpunësim në harmoni me kërkesat e tregut të punës;

1.17. **ZP** - Zyrat e Punësimit.

2. Në tërë tekstin e ligjit bazik, fjalët “Komision Profesional, Komisioni Mjekësor dhe Komisioni për ekspertizë”, zëvendësohen me fjalët “Komisioni Mediko-social”.

3. Në tërë tekstin e ligjit bazik, fjalët “Qendrat për aftësim, riaftësim dhe punësim”, zëvendësohen me fjalët “Qendrat për aftësim profesional.”

### **Neni 3**

Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

1.1. Personi me aftësi të kufizuar, shfrytëzues i të drejtave dhe përfitimeve financiare sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 4**

Pas nenit 6 të ligjit bazik, shtohen dy nene të reja 6A dhe 6B, me tekstin si në vijim:

### **Neni 6A**

#### **Vlerësimi i aftësisë së mbetur për punë**

1. Vlerësimi i aftësisë së mbetur për punë dhe mundësitë për punësim apo mbajtjen (ruajtjen) e punës përfshinë kriteret mjekësore, sociale dhe kritere të tjera të cilët përcaktojnë mundësitë dhe aftësinë e personave me aftësi të kufizuara për inkuadrimin e domosdoshëm në tregun e punës dhe kryerjen e punëve në mënyrë të pavarur apo me mjetet ndihmuese teknike, përkatësisht punësimin në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta.
2. Vlerësimi i aftësisë së mbetur për punë të personave me aftësi të kufizuara vlerësohet nga Komisioni Mediko-social. Për mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të aftësisë së mbetur për punë të personave me aftësi të kufizuara MPMS-ja nxjerrë akt nënligjor.
3. Gjatë procesit të vlerësimit të aftësisë së mbetur për punë, caktohet gjendja sociale, psikologjike dhe faktorë të tjerë të cilët ndikojnë në aftësinë për punë dhe mundësitë e punësimit.
4. Fushëveprimi, kompetencat, përbërja dhe mandati i Komisionit Mediko-social, rregullohen me akte nënligjore të nxjerrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

### **Neni 6B**

#### **Konfidencialiteti**

Vlerësimi i aftësisë së mbetur për punë dhe mundësitë për punë apo ruajtjen e punës, duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të sigurojnë respektimin e personalitetit, dinjitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 5**

Në nenin 7 të ligjit bazik, paragrafi 1, fjalët “Ministrinë e Shëndetësisë”, fshihen nga teksti i ligjit.

## **Neni 6**

Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 2 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. Në kushte të veçanta, personat me aftësi të kufizuara, mund të punësohen në Punëtoritë Mbrojtëse, Qendrat Punuese dhe në punë të tjera, në bazë të aftësive të punës dhe sipas kushteve të përgjithshme mund të punësohen në tregun e hapur të punës ose ta mbajnë punën e vet.

## **Neni 7**

Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 3, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

3. Punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 i nenit 12 të ligjit bazik, obligohet që për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara të paguajë në një xhirollogari të veçantë në vijën buxhetore të Buxhetit të Kosovës, pagesat mujore në lartësi të shumës së pagës minimale të realizuar në Republikën e Kosovës, për çdo person me aftësi të kufizuar që duhet të kishte punësuar.

## **Neni 8**

Neni 12 i ligjit bazik, pas paragrafit 3, shtohet paragrafi i ri 3a, me tekstin si në vijim:

3a. Mënyrat, procedurat dhe afatet e pagesës mujore sipas paragrafit 1 të këtij neni, rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

## **Neni 9**

1. Në nenin 13 të ligjit bazik, paragrafët 1 dhe 2, pas fjalëve “Ligjit të Punës” shtohen fjalët “Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ligjeve të veçanta me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës”.

2. Neni 13 i ligjit bazik paragrafi 3 ndryshohet dhe plotësohet, me tekstin si në vijim:

3. Personi me aftësi të kufizuara vetëm me pëlqimin dhe me nënshkrimin e tij mund të punojë natën, jashtë orarit të punës ose me orar të ndryshuar, në harmoni me vlerësimin e Komisionit Medico-Social, i cili ia ka përcaktuar nivelin e aftësisë për punë.

## **Neni 10**

Neni 15 i ligjit bazik, pas nën-paragrafit 1.5 shtohet nën-paragraf i ri 1.5a, me tekstin si në vijim:

1.5a. Gjatë aftësimit, riaftësimit profesional për personat me aftësi të kufizuara të sigurohet interpretuesi i gjuhës së shenjave dhe asistenti në raste të nevojshme .

## **Neni 11**

1. Në nenin 18. të ligjit bazik, në fund të paragrafit 1, fjalia „ligjeve tatimore dhe doganore në fuqi” zëvendësohet me „një akti nënligjor të nxjerr nga Qeveria e Kosovës”.

2. Në nenin 18. të ligjit bazik, në fund të paragrafit 2. shtohet fjalia „dhe kjo të rregullohet me ligj të veçantë”.

## **Neni 12**

Neni 26 i ligjit bazik, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji e bën Inspektorati i Punës në bazë të Ligjit në fuqi për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

## **Neni 13**

### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, brenda afatit prej një (1) viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të nxjerrë aktet nënligjore që parashihen me këtë ligj.

## **Neni 14**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -078**  
**5 gusht 2016**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Kadri VESELI**